



Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Thirrja për aplikim

Raundi i 15-të i Fondit të Grave të Kosovës

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Ftojmë organizatat tona anëtare të aplikojnë me projekte të cilat do të **kontribujnë në avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave dhe barazisë gjinore në Kosovë.**

Më konkretisht, aplikacionet duhet të demonstrojnë se si organizatat propozojnë të kontribujnë në realizimin e Strategjisë dhe objektivave të saj të identifikuar nga anëtarët e RrGK-së, në kuadër të Strategjisë së RrGK-së për periudhën 2019-2022, duke avokuar për përkrahjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të grave dhe vajzave, të cilat promovojnë të drejtat e njeriut dhe synojnë të sjellin ndryshime afatgjata.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

RrGK inkurajon fuqishëm të ndërmirren **iniciativa avokuese në nivel lokal dhe qëndror**. Avokimi mund të përfshijë takime me zyrtarë të institucioneve, ngritjen e vetëdijes për të drejtat e njeriut, hulumtim të politikave, propozime për ndryshimin e politikave dhe inkurajimin e qytetarëve për t'i mbrojtur të drejtat e tyre. Këto iniciativa duhet të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të rëndësishme (p.sh., legjislacion i ri, shërbime të reja, raporte mbi rastet e dhunës me bazë gjinore, raste të monitoruara në gjykata, etj.). Ju lutemi keni parasysh që aktivitetet e ndërmarra **nuk konsiderohen si rezultate të arritura të projektit**.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Llojet e aktiviteteve që do të merren parasysh për përkrahje financiare përfshijnë:

organizimin e takimeve me gra dhe persona në pozita vendimmarrëse, organizimin e fushatave për vetëdijesim dhe avokim, ngritjen e kapaciteteve të grave dhe vajzave që të avokojnë për prioritetet e tyre, përkrahja e grave dhe vajzave në takime me politik-bërës për të influencuar ndryshime në ligjet ekzistuese dhe rregulloret që kanë të bëjnë me shqetësimet e tyre, hulumtime të orientuara drejt politikave, hulumtime të orientuara drejt avokimit, marrëdhëniet me publikun mbi çështjet avokuese, rrjetëzimin/shkëmbimin e përvojave me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së grave dhe vajzave dhe avancimin e të drejtave të tyre si e drejtë e njeriut, trajnime, tryeza të rrumbullakëta/diskutime dhe strategji të tjera avokuese.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Llojet e aktiviteteve që nuk do të merren parasysh përfshijnë: aktivitetet që lidhen pjesërisht ose plotësisht me sponsorizime individuale për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca dhe kongrese; veprimet që lidhen pjesërisht ose plotësisht me bursa individuale për studime ose kurse trajnimi; blerja e patundshmërive; blerja e automjeteve; blerja e pajisjeve (përveç nëse është e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të projektit); veprimet që përkrahin partitë, grupet dhe lëvizjet politike.

Më tej, në pajtueshmëri me [Strategjinë e RrGK për vitet 2019-2022](#), llojet e iniciativave të cilave do t'u jepet prioritet për financim do të përfshijnë:

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë

- Ngritja e kapaciteteve dhe përfshirja e të rinjve (vajzave dhe djemve) në avokimin për të drejtat e grave dhe vajzave për çështje specifike;
- Mobilizimi i personave me aftësi të kufizuara, pensionerëve, personave nga grupet etnike të minoriteteve (në kuadër të komunës së tyre) dhe grave dhe vajzave nga vendet rurale që të avokojnë për të drejtat e tyre lidhur me një çështje të caktuar;
- Bashkëpunimi me organizatat anëtare tjera, që ato të ndajnë njohuritë e tyre mes veti dhe njëkohësisht të ngrisin kapacitetet e anëtareve të tjera të Rrjetit; si dhe të rrisin solidaritetin në mes të organizatave të grave dhe vajzave;
- Konsultimi i raportit hulumtues të RrGK, [*Ku janë paratë për të Drejtat e Grave?*](#) dhe të dhëna të tjera në dispozicion për të informuar avokimin dhe ngritjen e vetëdijes për të drejtat e grave për çështje specifike.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Gratë në politikë dhe vendimmarrje

- Përfshirja e grave dhe vajzave në identifikimin e çështjeve prioritare të barazisë gjinore në komunat e tyre dhe përfshirja e tyre në avokimin direkt tek zyrtarët relevant për të adresuar këto çështje;
- Përfshirja e grave dhe vajzave në shqyrtimin e draft-dokumenteve të politikave në nivel lokal apo qendror, si dhe dhënia e kontributit të tyre (p.sh., dokumentet me buxhete, rregulloret e reja komunale, etj.). Kjo iniciativë përfshinë edhe marrëveshje paraprake me institucionet me të cilat do të punohet;
- Mbështetja e grave dhe vajzave në adresimin e interesave të tyre në lidhje me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), të cilat mund të përfshijnë, por jo domosdoshmërisht të kufizohen në: të avokohet tek BE për të ngritur çështjet me rëndësi për gratë si pjesë e dialogjeve politike me Qeverinë e Kosovës të ndërlidhura me procesin e antarësimit në BE; të avokohet që programet e Instrumentit të Para-Anëtarësimit në BE të përkrahin dhe adresojnë më mirë nevojat e grave, veçanërisht në nivel lokal; të monitorohet zbatimi i programeve të përkrahura nga BE në nivel lokal, duke siguruar që ato të kontribuojnë në barazinë gjinore dhe përfshirjen e grave në mënyrë të duhur; dhe/ose përfshirja e më shumë grave dhe burrave nga komuniteti për të kuptuar, përfshirë dhe/ose monitoruar reformat lidhur me anëtarësimin në BE në nivel lokal.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor

- Përfshirja e grave në avokim për të pasur qasje në kujdes më të mirë shëndetësor, si dhe marrjen e masave për të kërkuar kujdes shëndetësor cilësor, ofrimi i kushteve të volitshme për të pasur një sigurim shëndetësor, dhe raportimi i shkeljeve të të drejtave të grave në kujdesin shëndetësor cilësor;
- Bashkëpunimi i grave për t'i vetëdijesuar gratë dhe vajzat për të drejtat e tyre në kujdesin shëndetësor (sidomos për shëndetin riprodhues dhe shëndetin e nënave) dhe bashkëpunimi i tyre për t'i raportuar abuzimet në mënyrë zyrtare tek autoritetet përkatëse;
- Konsultimi i [raportit hulumtues të RrGK-së](#), [Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë](#) dhe të dhënave të tjera në dispozicion mbi qasjen e grave në kujdes cilësor shëndetësor në mënyrë që të përdoret për të kontribuar në avokim dhe ngritjen e vetëdijes.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



Jeta pa dhunë me bazë gjinore

- Avokimi tek institucionet përkatëse për personat të cilët kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore (p.sh., dhuna në familje, ngacmimet seksuale, ose dhunë seksuale gjatë luftës) të marrin shërbime më të mira;
- Avokim për ofrimin e shërbimeve më të mira për rehabilitim dhe ri-integrim të personave që kanë përjetuar dhunë;
- Monitorimi i rasteve gjyqësore lidhur me dhunën në familje dhe raportimi i zbatimit jo korrekt të ligjeve nga ana e gjykatave, si dhe avokimi tek institucionet përkatëse për të adresuar këto çështje;
- Mbështetja e grave dhe vajzave që kanë përjetuar ngacmim seksual në punë, në shkollë, apo në rrugë duke ju dhënë këshilla ligjore, duke i udhëzuar tek institucionet e duhura dhe duke i adresuar këto raste në institucionet përkatëse. Iniciativa mund të përfshijë gjithashtu edhe informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre lidhur me trajtimin e ngacmimeve seksuale;

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



- Organizimi i fushatave për ndërgjegjësimin e grave, burrave dhe institucioneve për kornizën ligjore dhe mekanizmat kundër dhunës (në familje) dhe ngacmimeve seksuale;
- Konsultimi i raporteve hulumtuese të RrGK, sikurse raporti [*Nga Ligjet në Vepra?*](#) i publikuar në vitin 2021 i cili ka për qëllim monitorimin e reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë, dhe raporti [*Ngacmimi Seksual në Kosovë*](#) i publikuar në vitin 2016 që ka për synim zbatimin e kornizës përkatëse ligjore nga ana e institucioneve publike përgjegjëse, me qëllim të informimit të avokatisë që i bën institucionet individuale të përgjegjshme dhe përmirëson qasjen e tyre në adresimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore;
- Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe bizneset për të krijuar mekanizma për adresimin e ngacmimeve seksuale;
- Mbështetja ligjore dhe psikosociale për gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës që të avokojnë për të drejtat e tyre në bazë të kornizës ligjore dhe / ose mbrojtjen e ndryshimeve në kornizën ligjore për të adresuar më mirë nevojat e tyre.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Fuqizimi ekonomik i grave

- Avokimi tek autoritetet komunale ose qendrore për politikat të cilat inkurajojnë dhe mbështesin fuqizimin ekonomik të grave (p.sh., më shumë subvencione bujqësore për gratë dhe burrat, ndarje të barabartë të granteve qeveritare për zhvillimin e bizneseve për gratë dhe burrat, hapja e më shumë çerdheve publike për kujdesin e fëmijëve që do të sigurojë vende pune për gratë dhe do t'iu mundësojë grave që të punojnë);
- Puna me Qendrat Rajonale të Punësimit për të inkurajuar ata të mbështesin më shumë gra që të punësohen;
- Përmirësimi i perspektivës gjinore mbi reformat në lidhje me procesin e pranimin në BE në lidhje me punësimin e grave;

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



- Pjesëmarrja në punëtori mbi ngritjen e kapaciteteve dhe mentorime të përshtatura nga RrGK për të fituar njohuri të reja mbi politikat e mira për familjen dhe përdorimi i tyre për të mbështetur punëdhënësit lokalë në krijimin e politikave të mira për familjen, edukimin e punonjësve për përfitimet e politikave të tilla, si dhe avokimi për politika të tjera të mira për familjen në nivelin komunal dhe / ose monitorimi i zbatimit të këtyre politikave;
- Mbështetja e zbatimit të politikave të mira ndaj familjes nga punëdhënësit që janë zotuar për krijimin e tyre;
- Edukimi i punonjësve për përfitimet e politikave të tilla;
- Avokimi për politika të tjera të mira për familjen në nivelin komunal;
- Monitorimi i zbatimit të politikave të tilla.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor

- Avokimi në nivel lokal dhe qendror për ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve për nevojën e më shumë qendrave parashkollore dhe qendrave të kujdesit për fëmijë;
- Avokimi për përmirësimin e edukimit seksual në shkolla, dhe/ose në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI); si dhe monitorimi i institucioneve parashkollore dhe qendrave të kujdesit ditor lidhur me cilësinë e arsimit të ofruar në përputhje me legjislacionin e arsimit parashkollor, si dhe avokimi i përfshirjes së mësimdhënies drejt transformimit të normave tradicionale gjinore;
- Bashkëpunimi me MASHTI për rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulave në shkolla në nivel tjetër nga një perspektivë gjinore drejt transformimit të normave gjinore.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



NDARJA E GRANTEVE

Grantet të cilat do të ndahen në këtë raund do të marrin mbështetje nga iniciativat e RrGK mbështetur nga këta donatorë:

- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë – "Fuqizimi i pjesëmarrjes së grave në politikë" në vlerë prej 90,000€;
- Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) – "Avancimi i iniciativës për të drejtat e grave II" bashkëfinancuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) në vlerë prej 50,000€;
- Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara (UNFPA) – "Zgjedhjet Zgjeruese: Politikat Familjare të Përgjegjshme Gjinore për Sektorin Privat në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavinë" financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) në vlerë prej 20,000€.

Shuma totale që pritet të shpërndahet gjatë këtij raundi është 160,000€.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

MADHËSIA, LLOJET DHE KOHËZGJATJA E GRANTEVE

Në tabelën më poshtë janë të përshkruara llojet dhe kategoritë e granteve të cilave do t'u jepet prioritet për financim në bazë të Strategjisë së RrGK për vitet 2019-2022.

Fushat programatike të Strategjisë së RrGK	Shuma maksimale për grant	# i granteve të parashikuara	Shuma e përafërt për fusha	Donatori
• Gratë në politikë dhe vendimmarrje	5,000€	18	90,000€	Zyra e BE në Kosovë
• Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë • Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor • Jeta pa dhunë me bazë gjinore • Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor	5,000€	10	50,000€	ADA me bashkë-financim të Sida
• Fuqizimi Ekonomik i Grave	5,000€	4	20,000€	UNFPA financuar nga ADA

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Projektet pritet të fillojnë rreth 1 shtatorit 2021 dhe mund të zgjasin maksimalisht deri në dymbëdhjetë (12) muaj, nga momenti i nënshkrimit të kontratës. RrGK rezervon të drejtën të financojë disa apo asnjë nga aplikacionet e paraqitura, si dhe të diskutojë me organizatat aplikuese alokimin e aktiviteteve sipas nevojës duke mos dalur jashtë kategorive të lartëpërmendura. Vendimi final do të mirret nga Komisioni për Vlerësimin e Granteve (KVG) i FGK-së, i cili është përzgjedhur nga organizatat anëtares të RrGK.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



KUSHTET E PËRZGJEDHJES

Organizatat që aplikojnë duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

1. Të planifikojnë dhe të zbatojnë aktivitete në përputhje me strategjinë e tyre organizative;
2. Të ndërmarrin aktivitete që kontribuojnë në zbatimin e Strategjisë së RrGK-së 2019-2022, që përfshinë programet në vazhdim:
 - o Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë;
 - o Gratë në politikë dhe vendimmarrje;
 - o Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor;
 - o Jeta pa dhunë me bazë gjinore;
 - o Fuqizimi ekonomik i grave;
 - o Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor.
3. Të sigurojnë 10% të kostos totale të projektit nga ndonjë donator tjetër apo vetëkontribut (p.sh. punën vullnetare të dokumentuar). Shuma e 10% duhet të pasqyrohet në buxhetin e propozuar;
4. Nuk duhet të ketë anëtare të stafit që janë aktualisht pjesë e bordit të RrGK, ose pjesë e KVG-së.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



KVG do t'ju japë prioritet për financim:

- Anëtareve të RrGK-së;
- Iniciativave avokuese për të sjellë ndryshime afatgjata në përkrahjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në nivel lokal dhe/ose qendror;
- Iniciativave që kanë për qëllim të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të rëndësishme (p.sh., legjislacion i ri, shërbime të reja të nevojshme, raporte mbi rastet e dhunës me bazë gjinore, raste të monitoruara në gjykata, kurrikula gjinore-transformuese, politika të mira ndaj familjes në ndërmarrjet private etj.);
- Iniciativa që angazhojnë persona me aftësi të ndryshme; grupet etnike të minoriteteve; dhe grupet e marginalizuara;
- Organizatave të cilave ju mungojnë mundësi tjera të sigurimit të fondeve nga donatorë të ndryshëm.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



Propozimet e paraqitura RrGK-së duhet të jenë punë origjinale që i përkasin vetëm organizatës aplikuese. Plagjiatura do të rezultojë në diskualifikimin nga procesi i vlerësimit të mëtutjeshëm.

RrGK do të mbajë të gjitha materialet dhe dokumentet e dorëzuara nga aplikantët. RrGK nuk do të përdorë informacionin e paraqitur nga aplikantët për qëllime të tjera, përveç shqyrtimit dhe nuk do të ofrojë këtë informacion për persona të tjerë apo institucione, përveç kur kërkohet nga ligjet e Kosovës ose nga donatorët.

Pas dorëzimit të aplikacioneve, organizatat aplikuese do të marrin një letër konfirmimi të pranimit me një numër të aplikimit, të nënshkruar nga stafi i RrGK-së.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



PROCEDURAT E APLIKIMIT

RrGK do të pranojë aplikacione të shkruara në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Aplikimet mund të dorëzohen në e-mail adresën: grants@womensnetwork.org. Aplikuesit duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

Aplikacionin, duke përdorur formën e aplikimit të RrGK-së (në formatin Word, e bashkangjitur dhe në dispozicion në: www.womensnetwork.org); dhe

Propozimin e buxheti, duke përdorur formën e RrGK-së (në formatin Excel, të bashkangjitur dhe në dispozicion në: www.womensnetwork.org);

Ju lutemi vini re: të gjitha buxhetet duhet të paraqesin ndarje të shpenzimeve (që do të thotë bashkë-financim nga një tjetër institucion) dhe/ose kontribut jo-financiar (që nënkupton punë vullnetare, kontribute të dhuruara nga bizneset, përfshirja e komunitetit) në vlerë prej 10% të buxhetit të përgjithshëm që është propozuar. Kjo duhet të ceket në buxhetin e propozuar. FGK mund të konsiderojë mbulimin e pagave dhe shpenzimet operative por vetëm në rastet kur aplikuesi të ketë bërë një spjegim të qartë se si mbulimi i tillë do t'ju mundësojë atyre avancimin e të drejtave të grave dhe/ose barazinë gjinore.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Forma Narrative e Aplikimit

Informatat kontaktuese të organizatës:	
Emri i organizatës:	
Adresa:	
Telefoni (mobili dhe/ose fiks):	
E-maili:	
Personi përgjegjës (I): Përgjegjës për pjesën narrative të aplikacionit	
Kontakti i personit përgjegjës (I): Telefoni (mobili dhe/ose fiks):	
Personi përgjegjës (II): Përgjegjës për pjesën financiare të aplikacionit	
Kontakti i personit përgjegjës (II): Telefoni (mobili dhe/ose fiks):	

**Preferohet që
këtu ta shkruani
kontaktin e
financierit/es**

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

**Mbajtësi i
llogarisë apo
emri i llogarisë
bankare të
organizatës**

Detajet bankare të organizatës:

Mbajtësi i llogarisë:

Numri i llogarisë:

Emri i bankës:

Numri i postës:

Qyteti:

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

1. Titulli i projektit:

2. Përshkrimi i organizatës dhe historiku i saj (*gjysmë faqe*)

2.1 Kur është themeluar organizata e juaj?

2.2 Çfarë përvoja keni ju lidhur me këtë projekt? Nëse organizata juaj është e re, ju lutemi tregoni arsyen pse e keni themeluar organizatën dhe çka planifikoni të bëni në të ardhmen?

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



3. Cili është misioni i organizatës tuaj?

Misioni i organizatës përcakton *përse* ekziston organizata dhe orienton se *çfarë* duhet të bëjë ajo

Misioni i organizatës përcakton:

- ***Çfarë* organizata përpiqet të plotësoj,**
- ***Kujt* do ti shërbejë,**
- ***Si* do ti realizojë këto qëllime (çfarë aktivitete)**
- ***Pse*, cili do jetë roli i sajë në shoqëri**

P.sh. Misioni i Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) është që të përkrahë, mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht bindjeve të tyre politike, fetare, moshës, nivelit të edukimit, orientimit seksual dhe aftësive. RrGK e ka vizion një Kosovë në të cilën gratë dhe burrat janë të barabartë dhe kanë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje politike, kujdes shëndetësor dhe një jetë pa dhunë.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

4. Cila është struktura juaj organizative?

4.1 Sa anëtarë të stafit keni (me pagesë dhe pa pagesë)?

--

4.2 Sa vullnetarë i keni në kuadër të organizatës tuaj? Si janë të përfshirë ata në punën tuaj? Sa shpesh përfshihen?

--

4.3 A jeni organizatë me anëtarësi? Nëse po, sa anëtare i keni në kuadër të organizatës tuaj?

--

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

5. Cila është periudha kohore e propozuar për projektin tuaj (data e planifikuar e fillimit dhe mbarimit të projektit)?

- **Thirrja e hapur deri më 8 qershor**
- **Procesi i shqyrtimit të aplikacioneve deri në fillim të korrikut.**
- **Shqyrtimi nga ana e Komisionit për Vlerësimin e Granteve deri në fillim të muajit gusht.**
- **Vlerësimi i riskut dhe përgatitja e kontratave deri më fund të muajit gusht**
- **Sesioni orientues, në javën e parë të muajit shtator**

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian




With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

6. Pse dëshironi të zbatoni këtë projekt?

6.1 Analiza e problemit: Cili është problemi që projekti juaj synon të trajtojë?



Zbatuar nga:



- Analiza ka për qëllim të identifikojë problemet që kanë prioritet të lartë për aktorët dhe të cilat ata dëshirojnë ti tejkalojnë. Prandaj analiza e qartë e problemit siguron një bazë të shëndoshë mbi të cilën mund të formulohen qëllime relevante për projektin.
- Identifikimi i problemeve kryesore me të cilët ballafaqohen grupet qëllimore dhe përfituesit (Cili/Cilët është/janë problemi/et? Problemet e kujt?); dhe
- Prezantimi i problemeve në një formë diagrami të ashtuquajtur "pema e problemeve" ose "hierarkia e problemeve" me qëllim që të analizohen dhe sqarohen marrëdhëniet shkak-pasojë.
- Cilat janë problemet kryesore dhe shkaktarët burimorë të tyre që dëshironi t'i trajtoni?



Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



7. Me kë dëshironi të punoni (grupi synues dhe përfituesit)?

- **Kush janë personat me të cilët do të punoni?**
- **Kush është grupi synues?**
- **P.sh nëse projekti juaj synon të bënë ndryshimin e ndonjë politike në nivel lokal, atëherë grupi synues janë zyrtarët tek të cilët do të avokoni.**
- **Kush është grupi përfitues?**
- **Në shembulli më lartë grupi përfitues janë personat të cilët do përfitojnë nga ndryshimi i politikës për të cilën keni avokuar ju.**

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

8. Cilat janë aktivitetet e planifikuara të këtij projekti? (Mos haroni të shkruani aktivitetet që planifikoni për avokim)

- Aktivitetet përdorin folje vepruese (organizimi, trajnimin, edukimi)
- Aktivitetet janë detyrat që duhet të ndërmerren për të ofruar rezultatet e dëshiruara
- Fokusi i projektit është në rezultate jo në aktivitetet: cilat aktivitete ju duhen për arritjen e këtyre rezultateve?
- Mos e vëni peshën e projekt-propozimit tuaj në aktivitetet e projektit. Në vend të kësaj, identifikoni qëllimin tuaj afatgjatë dhe më pastaj aktivitetet më të dobishme që do të çojnë në arritjen e qëllimit.
- Shkakësia në zinxhirin e rezultateve logjike:

Zbatuar nga:






Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

9. Cilat janë rezultatet e menjëhershme të cilat synoni t'i arrini gjatë zbatimit të këtyre aktiviteteve?

- **Rezultatet** janë ndryshimi që PRITNI të shihni; produkti final i aktivitetit; duhet të jenë të arritshme gjatë projektit tuaj dhe duhet të jenë tërësisht nën kontrollin tuaj
- Duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme, realist dhe të përcaktuar në terma kohorë

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

10. Cilat janë objektivat specifike të cilat synoni t'i arrini gjatë këtij projekti, nëpërmjet aktiviteteve dhe rezultateve të menjëhershme?

- ***Objektivat* janë ndryshimi i menjëhershëm që DËSHIRONI të shihni; ndikimet e menjëhershme tek përfituesit, por as që është në tërësi nën kontrollin tuaj**
- **Nëse i bëjmë këto AKTIVITETE, atëherë do të arrijmë REZULTATET E PRITURA; nëse arrijmë REZULTATET, atëherë do të arrijmë këtë OBJEKTIV**

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



11. Për arritjen e cilit qëllim brenda strategjisë së RrGK do të kontribuoni me këtë projekt? (Bëj me shenjë të gjitha kutitë që lidhen me projektin tuaj)

- ☐ Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë;
- ☐ Gratë në politikë dhe vendimmarrje;
- ☐ Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor;
- ☐ Jeta pa dhunë me bazë gjinore;
- ☐ Fuqizimi ekonomik i grave;
- ☐ Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor.

11.1 Ju lutem shpjegoni se si do të kontribuojë projekti juaj në përmbushjen e këtij qëllimi (nëse keni bërë me shenjë vetëm një opcion) apo të këtyre qëllimeve (nëse keni bërë me shenjë disa opsione)?

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

12. Cila është objektiva gjithëpërfshirëse e projektit tuaj, për përmbushjen e së cilës do të kontribuojë projekti juaj (vetëm një fjali)?

**Ajo që SHPRESONI të shini; përmirësimet
afatgjate në shoqëri**

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

13. Analiza e rrezikut: Ju lutemi renditni aktivitetet që planifikoni të ndërmerrni dhe rreziqet e mundshme që mund t'ju ndalojnë të arrini qëllimet tuaja ("rezultatet").

Aktivitetet	Rezultati	Rreziku i mundshëm	Masa e ndërmarrë
<i>Shembull (ju lutem fshijeni këtë në aplikacionin tuaj)</i> <i>Aktiviteti 1. Takimi me gratë asambliste</i> <i># takime do të mbahen me gratë anëtare të kuvendit në komunën e Mitrovicës. Gjatë takimit do të diskutohen çështjet si në vijim:</i>		<i>Takimet mund të mos mbahen fizikisht për shkak të masave Covid-19</i>	<i>Takimet do të mbahen online, duke përdorur platformën Skype apo Zoom</i>
Aktiviteti 2:			

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 Sida
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

14. Si planifikoni të monitoroni dhe vlerësoni projektin tuaj (për të parë se a i keni arritur rezultatet dhe objektivat tuaja të pritura, dhe se të njëjtat kontribuan në objektivën tuaj gjithpërfshirëse)?

- **Monitorimi dhe vlerësimi janë vendimtare për të ditur nëse kemi arritur rezultatet e pritura në mënyrë efektive dhe efikase, dhe nëse kemi bërë përparim drejt qëllimit tonë afatgjatë.**
- **Në vlerësimin e projektit zakonisht përfshihen palët e interesit**
- **Shumë njerëz shfrytëzojnë këto informacione (stafi, donatorët, përfituesit)**
- **Burimet e të dhënave mund të përfshijnë dokumente të brendshme/të jashtme, raporte, rishikime pjesëmarrëse nga palët e interesit, raportet e konsulentit, fletat e vlerësimit etj.**

Zbatuar nga:



Microsoft Excel
Worksheet



Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

15. Si do t'i përfshini përfituesit/et e projektit tuaj në vlerësimin dhe monitorimin e projektit dhe rezultateve të tij?

A jeni duke zbatuar ndonjë projekt tjetër për momentin? Nëse po, ju lutem shkruani emrin e projektit, nga kush financohet si dhe shumën e financimit.

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

16. A jeni të financuar nga ndonjë donator tjetër për këtë projekt? Nëse po, ju lutem tregoni për sa kohë dhe sa është shuma e financimit?

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



17. Përshkruani përgjegjësitë e pjesëtarëve të stafit që do të jenë të angazhuar në këtë projekt (Po ashtu përshkruani se si ndërlihet secila nga këto pozita me aktivitetet e planifikuara në pikën 8 të këtij aplikacioni):

Përshkruani përgjegjësitë e secilit nga pjesëtarët e stafit në bazë të aktiviteteve të parapara më lartë (8)

- **P.sh Koordinatorja do të jetë përgjegjëse për implementimin dhe mbarëvajtjen e projektit në bazë të planit të punës, për takimet me zyrtarët, aktivitetet avokuese, për organizimin e tryezës së rrumbullakët dhe përpilimin e raporteve narrative.**
- **Asistentja do të asistoj koordinatoren në organizimin e takimeve si dhe do të jetë përgjegjëse për përpilimin e broshurave/ fletushkave dhe mirëmbajtjen e data bazës së monitorimit dhe evaluimit.**
- **Financierja do të jetë përgjegjëse për përcjelljen e shpenzimeve dhe përpilimin e raporteve financiare**

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



18. Në tabelën më poshtë, shkruani informacione të detajuara rreth iniciativave avokuese që planifikoni t'i ndërmerrni si pjesë e aktiviteteve të projektit tuaj. (*Shembujt e vendosur në tabelë kanë qëllim t'iu ndihmojnë dhe orientojnë gjatë plotësimit të kësaj table)

Cili është qëllimi i avokimit?	Aktiviteti	Personi përgjegjës (brenda organizatës suaj)	Partnerët (të cilët do të ju ndihmojnë të avokoni)	Aktorët relevant	Strategjia për përfshirjen/për të fituar mbështetjen e aktorëve relevant
<i>Shembull (ju lutem fshijeni këtë në aplikacionin tuaj): Ngritja e vetëdijes për kujdes shëndetësor</i>	<i>Hulumtimi dhe shkrimi i letres me rekomandime</i>	<i>Koordinatori/ja e projektit</i>	<i>Organizatat anëtare të RrGK-së, RrGK</i>	Departamenti Komunal i Shëndetësisë, Departamenti i Buxhetit dhe Financave	<i>Ndahet projekti me partnerët për komente. Letër me rekomandime diskutohet gjatë takimeve.</i>
<i>Shembull (ju lutem fshijeni këtë në aplikacionin tuaj): Ngritja e vetëdijes për kujdes shëndetësor</i>	<i>Takimi me #asambleiste nga Mitrovica</i>	<i>Koordinatori/ja e projektit</i>		/	<i>Gratë do të ftohen të marrin pjesë përmes: ftesave derë më derë, thirrjeve telefonike dhe broshurave të shpërndara në komunitet</i>
<i>Shembull (ju lutem fshijeni këtë në aplikacionin tuaj): Propozimi i rekomandimeve për...</i>	<i>Takimi me zyrtarët</i>	<i>Koordinatori/ja e projektit, Drejtorja Ekzekutive</i>	<i>Organizatat e tjera, RrGK</i>		<i>Ftesat zyrtare do të dërgohen përmes emailit. Zyrtarët do të kontaktohen përmes postave elektronike dhe numrave të tyre të telefonit</i>

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

19. Plani i punës (Në tabelën më poshtë janë shtuar kolonat për maksimumi 12 muaj të zbatimit të një iniciative, ku çdo muaj është i ndarë në katër (4) javë. Ju lutemi që ta plotësoni tabelën për aq muaj sa planifikohet kohëzgjatja e iniciativës suaj. Pasi që ta shtoni titullin e secilit aktivitet, ju lutemi që tek kutia përkatëse ta bëni me shenjë (X) javën brenda të cilës do mbahet aktiviteti i caktuar. *P.sh. Aktiviteti 1 do mbahet në javën e katërt të muajit të parë dhe në javën e tretë të muajit të tretë të implementimit të iniciativës.*)

Plani i punës																								
Aktivitetet	Muaji 1				Muaji 2				Muaji 3				Muaji 4				Muaji 5				Muaji 6			
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
Aktiviteti 1				x							x													

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Plani i punës																								
Aktivitetet	Muaji 7				Muaji 8				Muaji 9				Muaji 10				Muaji 11				Muaji 12			
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4

Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

 **Sida**
SWEDISH INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION AGENCY

Ky aplikacion është përgatitur për Fondin e Grave të Kosovës, të Rrjetit të Grave të Kosovës. Me nënshkrimin e këtij dokumenti, aplikuesi merr përgjegjësinë që informatat dhe të dhënat janë të sakta dhe relevante.

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit/es ligjor të organizatës:	
Titulli / Pozita e punës së përfaqësuesit/es:	
Nënshkrimi i përfaqësuesit/es:	
Data:	

Zbatuar nga:

